

KESHILLI BASHKISE KORCE

VENDIM

NR. 47 DATE 28/05/1999

MBI KRIJIMIN E NDERMARJES SE SHERBIMEVE PUBLIKE PRANE
BASHKISE KORCE


Keshilli i Bashkise se Korces i mbledhur ne daten e sotme, mbasi mori ne shqyrtim materialin e pergatitur nga grupi i punes "Per krijimin e sektoreve te mirembajtjes se rrugeve, banesave, vendstrehimeve dhe ndricimit te qytetit" ne zbatim te Ligjit 7572 date 10.06.1992 "Per organizimin dhe funksionimin e Pushtetit Lokal", neni 14, pika 9 dhe 11 mbas diskutimeve te anetareve :

VENDOSI

- 1.- Te shkeputet reparti i mirembajtjes se rrugeve nga Ndermarja e Ujesjelles, Kanalizime dhe Rruge.
- 2.- Te krijohet sektori i sherbimeve publike i cili do te permbledhe aktivitetin e mirembajtjes se rrugeve, banesave, vendstrehimeve dhe ndricimit te qytetit.
- 3.- Te priset Ndermarja e Gjelberimit dhe te krijohet ndermarja e re e emruar "Ndermarja e Sherbimeve Publike" prane Bashkise e cila do te jete e perbere nga sy sektore :
 - Sektori i sherbimeve Publike
 - Sektori i gjelberimit
- 4.- Nga Ndermarja Ujesjelles Kanalizime Rruge te kaloje ne dispozicion te Bashkise (Ndermarjes Sherbimeve Publike), te gjitha fondet, mjetet themelore, personeli tekniko - administrativ dhe fuqia punetore qe i takon aktivitetit te mirembajtje rruge, si dhe te plotesohet organika e sektorit te sherbimeve Publike me personelin e nevojshem sipas materialit te paraqitur.
- 5.- Ne nje mbledhje te ardhshme Keshilli i Bashkise te vendose per ngritjen e Keshillit drejtues te ndermarjes se re.
- 6.- Per zbatimin e ketij vendimi ngarkohet zyra e investimeve, finances, administrates, sherbimeve dhe Ndermarja e Ujesjellesit dhe Ndermarja e sapoemeruar.
- 7.- Ky vendim hyn ne fuqi menjehere.

Sekretar
Emanuel I. K...
Genc...



KRYETARI

NEIM TUXHARI